






Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

UDHËTIMI NËPËR INTERNET



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Zbatuar nga:





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

UDHËTIMI NËPËR INTERNET

UDHËZUES PËR MBROJTJEN E FËMIJËS NË INTERNET

PËR EDUKATORET NË
INSTITUCIONET PËR EDUKIMIN NË
FËMIJËRINË E HERSHME

Grup autoresh: Mimoza Hasani Pllana, Merita Jonuzi dhe Kujtime Kryeziu

Redaktor: Avni Rexha

Kontribues tjerë: Labëri Luzha, Udhëheqës të Institucioneve Parafillore, pedagogë, psikologë, edukatore dhe ekspert të fushës

Lektor: Afrore Lila

Ky Udhëzues është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrojtja e Fëmijëve të cenueshëm në Kosovë", financuar nga Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe UNICEF në Kosovë, dhe implementuar në bashkëpunim me Qendra për Arsim e Kosovës – KEC. Materialet, përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë Udhëzues janë ato të ekspertit të angazhuar dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BE-së, UNICEF-it dhe të KEC-it. Botimi nuk është redaktuar sipas standardeve zyrtare të publikimit të UNICEF-it dhe BE-së, të cilët nuk marrin përgjegjësi për ndonjë gabim drejtshkrimor.

Përmbajtja

07 HYRJE

10 RËNDËSIA E UDHËZUESIT PËR NIVELIN PARASHKOLLOR, NDËRLIDHJA ME POLITIKAT E EDUKIMIT, ZHVILLIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME

14 INSTRUKSIONE PËR STAFIN E INSTITUCIONEVE TË EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME RRETH PËRDORIMIT TË SIGURT DHE TË DOBISHËM TË INTERNETIT ME FËMIJË TË GRUPMOSHAVE TË NDRYSHME

18 ZHVILLIMI I MATERIALEVE ILUSTRUESE NËPËRMJET PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË

22 MBROJTJA E FËMIJËS NGA RREZIQET E PËRDORIMIT TË TIK

26 AKTIVITETE TË SUGJERUARA NË PARANDALIM TË RREZIQEVE NË INTERNET

29 HAPAT QË DUHET TË NDJEKË EDUKATORJA KUR VËREN SJELLJE TË DHUNSHME TE FËMIJA SI SHKAK I PËRDORIMIT TË MEDIES

32 UDHËZIMET E EDUKATORIT/ES PËR PRINDËRIT SE SI T'I MBROJNË FËMIJËT NË INTERNET

35 REZULTATE

37 SHTOJCAT

Shkurtesat



TIK	Teknologjia e Internetit dhe Informacionit
FIT	Qendra për Studime të Avancuara
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
EFH	Edukimi në Fëmijërinë e Hershme
KEFH	Kurrikula për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme
IAP	Institucionet e Arsimit Parafillor

Hyrje

Sipas politikave nacionale, bazuar në instrumentet ndërkombëtare, specifikiisht në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, institucionet tona duhet të kujdesen për mbrojtjen e fëmijës nga çdo rrethanë që e pengon apo e dëmton zhvillimin e fëmijës. Viteve të fundit ka hyrë në fuqi edhe Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe janë nxjerrë akte nënligjore dhe politika për mbrojtjen e fëmijës, të cilat kërkojnë angazhim e kujdes në mënyrën se si punohet me fëmijë, dhe për fëmijët. Në këtë linjë janë hartuar akte nënligjore, strategji, udhëzime specifike për temat e ndërlidhura me kontekstin e mbrojtjes.

Edhe mbrojtja në internet është brenda fushëveprimit të legjislacionit që lidhet me mbrojtjen e fëmijës, e cila padyshim është domosdoshmëri e kohës së sotme digjitale. Sipas Statistikave Botërore të Internetit (Internet World Stats) rritja e përdorimit të Internetit për periudhën 2000-2022 në nivel global ka qenë 1,416 %, me numër të përdoruesve në internet 5,473,055,736, ndërsa penetrimi i internetit në shkallë 69 %¹. Sipas platformës “Statista”, deri më 2030 do të ketë afërsisht 29 miliardë pajisje IoT në internet. Me këtë përdorim të madh të Internetit, si platformë kryesore e punës, shkencës dhe e komunikimit social të qytetarit modern, siguria dhe privatësia e tij kthehen në brengën kryesore².

Në Kosovë, përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është zgjeruar me shpejtësi nga viti 2000, ndërsa TIK-u në kohën e sotme luan rol të rëndësishëm në të gjitha aspektet e jetës sonë, tashmë. Në Raportin Digjital 2023 për Kosovën evidentohet se shkalla e depërtimit të internetit në Kosovë ishte 96.6 përqind e popullsisë së përgjithshme në fillim të vitit 2023³, ndërsa sipas rezultateve të Anketës TIK në Ekonomitë Familjare përqindja e ekonomive familjare që kishin qasje në internet gjatë vitit 2023 është rreth 98,6%. Ndërkohë që, 0,8% e ekonomive familjare kanë deklaruar se nuk kishin qasje në internet gjatë vitit 2023.⁴

Përderisa aspektet e keqpërdorimit të teknologjisë janë caq të ndjeshme, burimet nga sektori i sigurisë na tregojnë se shumë incidente dhe elemente të dhunës e rrethana tjera të dëmshme derivojnë nga abuzimet online.

Nga 831 fëmijë të shkollave tona që kanë marrë pjesë në hulumtimin e fundit për sigurinë në shkolla (2022), 94% e tyre kanë deklaruar se kanë telefon të mençur, dhe vetëm 6% e tyre nuk kanë telefon të mençur. Sa i përket qasjes së prindërve në përmbajtjen e asaj se çka shikohet nga fëmijët në telefonat e tyre, 73% e nxënësve kanë deklaruar se prindërit e tyre kanë qasje në pajisjet e tyre, dhe 27% e nxënësve kanë deklaruar se prindërit nuk kanë qasje në to. Kurse, sa i përket ndikimit të internetit në sjelljet e dhunshme të rinjtë, 77% e tyre kanë pohuar që përmbajtja e asaj se çfarë ata shikojnë online, ka ndikim në sjelljet e dhunshme të nxënësit.⁵

1 <https://www.internetworldstats.com/stats.htm>

2 <https://www.statista.com/statistics/1183457/iot-connected-devices-worldwide/>

3 <https://www.internetworldstats.com/europa2.htm#kv>

4 <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/7600>

5 Hulumtimi i sigurisë në shkollat parauniversitare në Kosovë, PK, OSBE, 2022.

Edhe hulumtimet e mëhershme të FIT (Qendra për Studime të Avancuara) tregojnë se përdorimi i internetit nga fëmijët në Kosovë është tepër i shtuar e se rrjedhimisht rreziqet nga ky përdorim janë të larta. Rreth 97% e fëmijëve që janë deklaruar se kanë qasje në internet, janë përgjigjur se kycjen në internet e bëjnë nga shtëpia e të dhënat tregojnë se fëmijët më së shumti e përdorin internetin nga dhoma e fjetjes (65%). Kjo tregon se fëmijët parapëlqejnë të kenë lirinë e tyre, privatësinë dhe me gjasë nuk dëshirojnë që të monitorohen. Përdorimi nga dhoma e ndejës është për 5% më i ulët krahasuar me dhomën e fjetjes.⁶ Në hulumtimin e radhës, në 2016, thuhet që “Shqetësues është fakti se kemi rritje drastike në numrin e përdoruesve të Instagramit nga fëmijët kosovarë (nga 22% në 70%) dhe po ashtu një përdorim mjaft të madh të rrjetit social Snapchat 50%). Krahasuar me faktin që Facebooku mund t’u shërbejë fëmijëve edhe për ngritje profesionale pasi që ka materiale të shumta me porosi edukative, vështirë është të konstatohet e njëjta edhe për rrjetet sociale Instagram e Snapchat, ngaqë të dy shërbejnë vetëm si mjet komunikimi virtual. Fëmijët kanë përfitime të ndryshme nga përdorimi i rrjetëve sociale nëse ato përdoren si duhet.⁷

Të dhëna të tilla, me arsytime pse dhe si e përdorin fëmijët internetin, që mund të hasen në hulumtime të ndryshme, na e shtojnë detyrimin dhe vëmendjen që të punohet më shumë në edukim dhe ndërgjegjësim për përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit. Ky udhëzues ofrohet për stafin e institucioneve që merren me edukimin në fëmijërinë e hershme.

6 <https://fit-ks.org/raporti-me-te-gjetura-nga-opinionet-e-femijeve-siguria-ne-internet/>

7 <https://fit-ks.org/raporti-siguria-e-femijeve-ne-internet-2016/>




1

Rëndësia e udhëzuesit për nivelin parashkollor, ndërlidhja me politikat e edukimit, zhvillimit në fëmijërinë e hershme

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e ka në prioritetë edukimin në fëmijërinë e hershme me Ligjin për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme⁸, me Kurrikulën për edukimin në fëmijërinë e hershme, me Planin Kombëtar për zhvillim 2030 të Qeverisë dhe Strategjinë e Arsimit 2022-2026, prandaj krahas garantimit të së drejtës për të gjithë fëmijët për edukim cilësor gjithëpërfshirës bazuar në nevojat individuale të tyre, edhe e ka në fokus kryesor zhvillimin, sigurinë, shëndetin, mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve., Ky udhëzues ka rëndësi të veçantë për fëmijën, sepse jep udhëzime e këshilla për të shtuar kujdesin që t'i mbrojë fëmijët nga gjërat, sjelljet apo rrethanat të cilat e dëmtojnë zhvillimin e tyre, pra për të shmangur gjërat që bien ndesh me parimet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (EFH) dhe Ligjin për EFH.

Siç është përcaktuar nga MASHTI përmes Kurrikulës për EFH, kompetencat që synohet të arrihen përmes edukimit të hershëm janë si në vijim:


8 Nenet 2,3, 5 dhe 6 të Lgjit 08/L-158 përedukiminnëfëmijërinë e hershme



Shihet qartë që kompetenca digjitale është brenda tyre dhe e mbështet secilën kompetencë, siç thuhet në Kurrikulën për edukimin në fëmijërinë e hershme dhe rëndësia e teknologjisë trajtohet plotësisht: "Duke përdorur teknologjinë gjatë edukimit në fëmijëri të hershme, mund të mbështetet zhvillimi i fëmijëve, jeta e përditshme duke krijuar hapësira digjitale si një burim, pasurim dhe mjet për transformimin e kontekstit... Tutje, brenda kurrikulës theksohet që "Po përjetojmë një "normalitet" të ri në një det pasigurish.", prandaj "Kur mendojmë për të ardhmen, është thelbësor përcaktimi i qartë i rolit të teknologjisë duke marrë parasysh gjithashtu shqetësimin për dinjitetin njerëzor, për privatësinë dhe për lirinë (KEFH). Pra, kur teknologjinë/ internetin e kemi pjesë të përditshmërisë sonë dhe fëmijët sado të vegjël nuk kanë mbetur jashtë rrethit të përdoruesve, edukatorët duhet të kujdesen që duke e përdorur teknologjinë në aktivitete edukative të kujdesen për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet që ekzistojnë, prandaj qëllimshëm kemi theksuar me ngjyrë kontekstin e sigurisë që e reflekton teksti i mësipërm, me metaforën "një det pasigurish" apo kur përmend shqetësimin për dinjitetin njerëzor, privatësinë dhe lirinë.

Ky udhëzues dedikuar institucioneve që merren me edukimin në fëmijërinë e hershme, u bë me qëllim që stafi i institucioneve të orientojë mirë dhe drejt përdorimin e teknologjisë për realizimin e planit të punës brenda institucionit, në përputhje me kërkesat e kurrikulës, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e fëmijëve e të prindërve për përdorimin e sigurt të internetit dhe për shmangien e abuzimeve online që e dëmtojnë dhe e pengojnë zhvillimin e fëmijëve.

Duke qenë se teknologjia - interneti është bërë domosdoshmëri e kohës, në udhëzues fillimisht flitet për dobinë e internetit e mandej për pjesën e mbrojtjes nga rreziqet e mundshme, pasi fëmijët tashmë kanë prirjen dhe shprehinë e madhe të përdorimit të celularëve dhe të pajisjeve të mençura. Stafi i institucionit duhet të krijojë lojëra e aktivitete edukative (po ashtu të mençura) që ndikojnë në edukimin e fëmijëve që t`i shmangen rreziqeve dhe abuzimeve online. Thjesht duhet të pretendohet që fëmijëve t`u zhvillohen kompetencat specifike.



2

Instruksione për stafin e institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme rreth përdorimit të sigurt dhe të dobishëm të internetit me fëmijë të grupmoshave të ndryshme

Teknologjia mund të jetë një mjet i dobishëm për edukatorët që punojnë me fëmijët në EFH, meqenëse ka burime të shumta që mund të përdoren për avancimin e përvojave të edukimit dhe të të nxënit me fëmijët e kësaj grupmoshe. Përdorimi i internetit ua lehtëson edukatorëve kombinimin e metodave me përmbajtje të reja ku përfshihet multimedia, elementet audio-vizuele, dhe ato ndërvepruese.

Të gjitha burimet (motorët e kërkimit Youtube Kids, Google Kids, aplikacionet me karakter edukativ, kanë parametrat dhe filtrat e sigurisë ku mund të gjinden aktivitete, ide, lojëra edukative e kreative, të cilat mund të përdoren për aktivitete me fëmijë. Më poshtë jepen disa nga të mirat ose përfitimet që mund të kenë edukatorët nga përdorimi i internetit, siç janë:

- Përgatitja e aktiviteteve
- Aplikimi i teknologjisë në aktivitete të larmishme
- Bashkëpunimi në mes të edukatorëve;
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me prindër;
- Zhvillimi profesional i vazhueshëm



PËRGATITJA E AKTIVITETEVE

E para gjë në listën e angazhimeve të edukatorëve është përgatitja e aktiviteteve sipas planifikimeve të rregullta dhe kuptohet që çdokush e përdor internetin të hulumtojë modele dhe praktika të mira të punës me fëmijë. Ndërkaq në funksion të zhvillimit të kompetencës digjitale, stafi edukativ hulumton aktivitetete që përfshijnë përdorimin e teknologjisë.



APLIKIMI I TEKNOLOGJISË NË AKTIVITETE TË LARMISHME

Kur institucioni përdor pajisje të teknologjisë digjitale, edukatori/ja mund dhe duhet t`u sqarojë fëmijëve se përse përdoret ajo e si përdoret ajo. Edukatori/ja demonstroi përdorimin e drejtë të teknologjisë/ pajisjeve të ndryshme duke krijuar të kuptuar dhe shprehur të drejta për përdorimin dhe qëllimin e tyre të fëmijët, me synimin që të reflektohen e të barten shprehjet edhe të prindërit si dhe në mjedisin e shtëpisë.



BASHKËPUNIMI NË MES TË EDUKATORËVE

Aplikacione të ndryshme online ofrojnë mundësi që lehtësojnë bashkëpunimin mes edukatorëve, në funksion të ndarjes së ideve, burimeve dhe praktikave të mira të edukimit, në nivel vendi e në nivel ndërkombëtar. Ky lloj bashkëpunimi mund të çojë në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e qasjeve, metodologjive dhe të metodave të edukimit si edhe për ndarjen e përvojave në mes tyre.



KOMUNIKIMI ME PRINDËRIT


Teknologjia është shumë e rëndësishme për edukatorët që të komunikojnë me prindërit, dhe jo vetëm. Përmes internetit edukatorët mund të shkëmbejnë biseda ditore dhe diskutime javore apo mujore ku përfshihen raporte për progresin e fëmijës, dokumentime të punës së tyre, dhe plane të aktiviteteve. Ky lloj komunikimi inkurajon përfshirjen e prindërve në procesin edukativ të fëmijës. Sikur edhe në rastet e komunikimit në takimet fizike, kur edukatorët në harmoni me kërkesat e legjislativës në fuqi, kujdesen për ruajtjen e privatësisë, edhe në komunikimet online me prindër kërkohet ruajtja e të dhënave konfidenciale për fëmijët e tjerë dhe për paraqitjen e tyre. Pra, në komunikimet me grup prindërisht komunikohet vetëm për aspektet e përgjithshme programore, organizative, koordinuese, etj., ndërkaq për aspektet e një fëmije komunikohet individualisht vetëm me prindin/kujdestarin ligjor. Kuptohet që komunikimi zhvillohet përmes mjeteve digjitale edhe me takimet e rregullta dhe në aktivitete me prindër në kopsht. Të gjitha format e komunikimit mund të shfrytëzohen ashtu që të organizohen projekte ose aktivitete edukative me prindër dhe me fëmijë, me fokus në përdorimin e sigurt të mjeteve digjitale dhe në mbrojtjen e privatësisë.



ZHVILLIMI PROFESIONAL

Teknologjia është e dobishme për edukatorët meqë ofron mundësi të shumta për zhvillim profesional. Përmes internetit, edukatorët mund të informohen për zhvillimet më të fundit të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe për metodologjitë e punës, me fokus në zhvillimin e kompetencës digjitale në fëmijërinë e hershme. Kjo qasje në internet kontribuon në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të edukatorëve paralelisht me kolegët e tyre në vende të ndryshme të botës. Në këtë pikë teknologjia ua lehtëson më shpejt edukatorëve përshtatjen me ndryshimet në metodologjitë e edukimit, ku përfshihen strategjitë dhe teknologjitë e reja. Në institucione të edukimit dhe në kopshte, interneti iu ofron mundësi edukatorëve që programin ta zhvillojnë me mjete edukative novatore, të cilat mundësojnë angazhim më të lartë dhe motivim të parashkollorëve, për shembull: aplikacionet arsimore, siç është aplikacioni “Rritu e mëso”, pastaj tabela digjitale përmes të cilave zhvillimi i aktiviteteve bëhet më dinamik dhe më tërheqës për fëmijët. Pra, kombinimi i metodave të punës është thelbësor në ditët e sotme, meqë sjell metoda bashkëkohore të edukimit në fëmijërinë e hershme.

Vëmendje: Megjithëse përdorimi i teknologjisë ofron përparësi të shumta, është e rëndësishme që edukatorët të përdorin teknologjinë dhe të dhënat me kujdes nga burimet e sigurta dhe edukative, duke u siguruar që aktivitetet të jenë të përshtatshme për zhvillimin e fëmijës, të sigurta dhe në përputhje me planet e aktiviteteve. Për më tepër, një qasje e ekuilibruar që përfshin një përzierje të aktiviteteve në internet dhe offline (aktivitete që realizohen pa internet) është thelbësore për një përvojë të plotë të edukimit në fëmijërinë e hershme. Pra duhet kuptuar se mjetet teknologjike mund të përdoren vetëm kur janë të domosdoshme për arritjen e qëllimeve edukative që i tejkalojnë qëllimet teknologjike, siç është përdorimi i një kodimi për arritjen e identifikimit të pemëve dhe të veçorive të tyre.



3

Zhvillimi i materialeve ilustruese nëpërmjet përdorimit të teknologjisë



UDHËZIME PËR EDUKATORËT

- Vizitoni dhe përdor faqet e internetit me përmbajtje edukative:
- Zgjidhni faqet e internetit që ofrojnë lojëra edukative dhe tërheqëse të krijuara posaçërisht për fëmijët 0- Zgjidhni faqe që trajtojnë kompetencat e gjuhës dhe komunikimit dhe të logjikës matematikore, përmes të cilave edukatorja përforcon planifikimet e saj me shembuj dhe përmbajtje shtesë. Numrat, përfshijnë procesin e njohjes së numrave, dhe jo domosdoshmerisht të shkrimit të numrave, dhe koncepteve të numërimit, renditjes, sasisë, etj. Nëpërmjet aktiviteteve që përfshijnë njohjen e numrave dhe klasifikimin, fëmijët rrisin aftësitë e tyre të të menduarit logjik. Platformat e ndryshme me aktivitete që mbështesin njohjen e koncepteve matematikore dhe logjike mund të mbështesin angazhimin e mëtejme të fëmijëve edhe në bashkëpunim me prindërit.
- Zgjidhni faqet e internetit të krijuara për parashkollorët që fokusohen në fusha të ndryshme, si matematika, zhvillimi i gjuhës, arti, muzika dhe natyra. Kujdes: gjatë përzgjedhjes së këtyre faqeve sigurohuni që përmbajtjet të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijëve dhe për planin e aktiviteteve, posaçërisht të rezultatet e të mësuarit praktik.
- Zgjidhni faqet e internetit të tregimit të përrallave. Aty gjeni përralla të mira dhe mundësi të krijimit të tyre;
- Përzgjidhni faqe të internetit të cilat mbështesin zhvillimin e kompetencave të përcaktuara në kurrikulën e EFH;
- Bëni udhëtime kulturore! Meqenëse moshën e fëmijëve është e vogël dhe nuk mund të bëni udhëtime të gjata në terren dhe vende kulturore, bëni udhëtime virtuale për eksplorimin të ndryshme në vend dhe në mbarë botën.
- Si bëhen këto udhëtime?

- Mund të përdorni motorin e kërkimit Google Earth ose turne virtuale në muze, galeri, opera, etj., që t'u prezantohet fëmijëve kultura vendore dhe kultura të reja.



ZGJIDHNI FAQET E INTERNETIT KU KA VIDEO TË CILAT KANË PËR QËLLIM ARGËTIMIN DHE PËRCJELLJEN E INFORMATAVE EDUKATIVE PËRMES KËNGËVE OSE AKTIVITETEVE:

- Këngët edukative janë pjesë e programeve parashkollore meqë fokusohen në koncepte të rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve të kësaj moshe. Platformat si YouTube Kids kanë përmbajtje të larmishme këngësh me tema të përshtatshme posaçërisht për fëmijët e kësaj moshe. MASHTI gjithashtu ka platformën online për aktivitete në distancë, e cila mund të përdoret nga edukatorët dhe nga prindërit, ashtu që mund të përfitojnë të gjithë fëmijët, në institucione dhe në familje. <https://edukimihershem.rks-gov.net/>.



GJENI FAQE PËR VIZATIM DHE NGJYROSJE VIRTUALE:

- Vizatimi dhe ngjyrosja është e përfshirë në programet parashkollore si një nga fushat më të rëndësishme. Sa i përket përdorimit të internetit, ka platforma online që i lejojnë fëmijët të eksplorojnë anën e tyre artistike përmes ngjyrosjes dhe vizatimit virtual. Faqet e internetit mund të jenë tërheqëse për parashkollorët. Jua prezantojmë një faqe interneti për vizatim dhe ngjyrosje virtuale, mjaft tërheqëse për fëmijët, ndërkohë që ju mund të zgjidhni edhe faqe tjera që mbështesin artin: <http://www.tuxpaint.org/>.



HULUMTONI LOJËRA DHE ENIGMA ATRAKTIVE

- Zgjidhni enigma dhe lojëra në internet të përshtatshme për moshën që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të shkëlqyera motorike, aftësive për zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik.
- Edukatorët janë ata/ato që kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm kognitiv, gjuhësor dhe social -emocional të parashkollorëve dhe të nxënësve të ardhshëm.



4

Mbrojtja e fëmijës nga rreziqet e përdorimit të TIK

Meqë interneti dhe epoka digjitale aq sa i kanë përparësitë e dobitë e listuara më lart kanë edhe rreziqe dhe elemente të dëmshme, duhet që fëmijët të marrin njohuritë e duhura në familje dhe në institucionet e EFH dhe të krjojnë shprehi dhe sjellje të mira në çdo formë komunikimi, loje, argëtimi apo hulumtimi online. Po e përdorim edhe fjalën hulumtim, duke e pasur parasysh që kurrikula e edukimit në fëmijërinë e hershme synon që fëmijët të hulumtojnë, eksplorojnë, të jenë kreativë, komunikues, bashkëpunues dhe t'i fitojnë shkathësitë jetësore mbi të cilat zhvillohen tutje përgjatë rritjes. Thjesht fëmijët duhet ta kuptojnë që jetojnë në kohën ku paralelisht funksionojnë bota reale me atë virtuale (meqë në vazhdimësi e kemi përmendur nëpër udhëzues që fëmijët krahas lojës, mësimi në internet, duhet të luajnë jashtë dhe të vizitojnë bibliotekat, etj. Shih udhëzuesit paraprak).

Si staf edukativ duhet t'i njihni rreziqet në internet për të kuptuarit dhe ideimin e aktiviteteve tuaja në funksion të mbrojtjes, prandaj në vijim po i listojmë disa nga rreziqet e mundshme.

Siguria në internet trajton tri rreziqe kryesore me të cilat përballen fëmijët e vegjël në internet. Këto janë rreziqet e kontaktit, të sjelljes dhe të përmbajtjes.

1. RREZIQET E KONTAKTIT

Rreziqet e kontaktit përfshijnë:

- Rrezikun e humbjes së privatësisë dhe rrezikun e kanosjes;
- Komunikimin me persona të panjohur;
- Rrezikun e mbledhjes dhe të keqpërdorimit të të dhënave të fëmijëve, siç është regjistrimi i aktivitetit të tyre në një lojë online;
- Ekspozimi i fëmijëve ndaj energjisë së valëve elektromagnetike që transmetojnë celularët dhe pajisjet tjera teknologjike. Kjo energji mund të ndikojë në shëndetin e fëmijëve.
- Qëndrimi i gjatë ulur para kompjuterit, laptopit apo me celular në dorë mund të krijojë probleme shëndetësore, përfshirë problemet me peshën, zhvillimin kockor, shmangien

nga loja në natyrë, mbylljen në vete, dëmet në socializim, rritjen të agresivitetit, uljen e vëmendjes dhe përqendrimit, etj.

- Rreziqet e ekspozimit të fëmijëve në faqet e internetit nga ana e edukatorëve (facebook, shkëmbimet grupore në viber) përmes fotove ku ata shihen qartë, me pretekstin e dokumentimit të punës së tyre, përderisa vet ekspozimi krijon mundësi për kanosjen e rreziqeve që duhet të përmenden.

2. RREZIQET E SJELLJES

Fëmijët duhet të edukohen që të qëndrojnë larg sjelljeve të rrezikshme e të dëmshme si:

- Ngacmimet;
- Abuzimet online;
- Keqpërdorimi e shfrytëzimi;
- Joshjet dhe mashtrimet online, etj.

Ata duhet të edukohen që të sillen me respekt për veten dhe të tjerët në internet dhe të edukohen për menaxhimin e gjurmëve digjitale, duke bashkëvepruar me prindërit, kujdestarët ligjorë, vëllezër e motra të rritur, etj.

3. RREZIQET E PËRMBAJTJES

Këto rreziqe kanë të bëjnë me llojin e materialit që fëmijët shohin dhe konsumojnë kur hyjnë në internet, si:

- Përmbajtjet e dhunshme;
- Përmbajtjet tragjike;
- Përmbajtjet pornografike (një përkufizim është dhënë me Nenin 2 c të Protokollit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve. Pornografia e Fëmijëve nënkupton çdo paraqitje, me çfarëdo mjeti, të një fëmije të përfshirë në aktivitete seksuale reale ose të simuluar, ose çdo paraqitje e pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale)⁹.

Ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, të dhunshme, të dëmshme për zhvillimin e fëmijës dëmtojnë shëndetin mendor dhe ndikojnë negativisht në sjelljet dhe në jetën e tyre në përgjithësi.

⁹ Protokollin Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve, 2002. Shënim: Përkufizimi i dhënë në Protokollin Fakultativ nuk mbulon në mënyrë eksplicite format e pornografisë imagjinare për fëmijë, siç janë pamjet reale. Për të siguruar që një material i tillë mbulohet gjithashtu, disa korniza ligjore, si Konventa e Këshillit të Evropës për krimin kibernetik, kanë ndryshuar përkufizimin e pornografisë së fëmijëve.

Për fëmijët e moshës parashkollore, rreziqet e përmbajtjes përfshijnë shikimin aksidental të përmbajtjes së papërshtatshme, si p.sh. dhunë, informata të pasakta e deri te pornografia. Përmbajtja gjithashtu merr parasysh cilësinë e materialit të vënë në dispozicion të fëmijëve.

Rreziqet e kontaktit kanë më shumë gjasa të ndodhin për fëmijët e moshës parashkollore në formën e pop-up-eve. Fëmijët e kësaj moshe mund të jenë gjithashtu aktivë në botë virtuale, si në lojërat e tipit Pocoyo World ose Club Penguin, ku mund të angazhohen me anëtarë të tjerë. Fëmijët mund të mos i njohin gjithmonë anëtarët me të cilët po luajnë virtualisht. Kjo situatë mund të krijojë rrezik për fëmijën në forma të ndryshme (si nxitja në aktivitete të dëmshme, mashtrimi, etj), prandaj sugjerohet loja në bashkëveprim me prindërit apo me kujdestarët ligjorë.

Sjellja përfshin të mësuarit se si të jesh i respektuar në internet. Edukatorët dhe prindërit mund të modelojnë sjellje të mira për fëmijët e tyre duke kërkuar gjithmonë leje për të bërë foto apo për ndarjen e tyre në rrjete sociale.

Shembull shumë i mirë i rreziqeve në internet është edhe ky artikull për përdorimin e YouTube <https://theconversation.com/the-way-your-children-watch-youtube-is-not-that-surprising-but-it-is-a-concern-here-are-some-tips-87597>.

Ndonëse fëmijët e vegjël në institucione parashkollore nuk i njohin këto elemente dhe nuk u shpjegohen si të tilla, edukatorët/et duhet të planifikojnë aktivitete edukative që fëmijët duke u rritur të përvetësojnë shprehi të mira të përdorimit të pajisjeve teknologjike, përfshirë tabletët apo telefonët e mençur, laptopët, etj. Ata që në vegjëli duhet të mësojnë që, sikur për çdo të mirë materiale e jo materiale, po ashtu edhe për mjetet, pajisjet e mençura se duhet t'i përdorin në mënyrë të dobishme e të përgjegjshme, për të mirën individuale e kolektive.

Shenjat e pasojave dhe rreziqeve që mund t`u jenë ekspozuar fëmijët mund të vërehen nga edukatorët në këto situata dhe jo vetëm, kur:

- përdorin fjalë e shprehje të papërshtatshme për moshën e tyre,
- demonstrojnë sjellje agresive;
- humbasin shkathtësinë e njohjes së emocioneve të tyre dhe të të tjerëve;
- humbasin interesimin e eksplorimit të rrethit të tyre dhe të marrëdhënieve me të tjerët;
- humbasin interesimin për lojën apo tërhiqen në vete.



5

AKTIVITETE TË SUGJERUARA NË PARANDALIM TË RREZIQEVE NË INTERNET

Edukatorët dhe stafi mbështetës edukativ duhet të planifikojnë aktivitete të ndryshme të cilat ndjekin interesat dhe nevojat e fëmijëve dhe që synojnë zhvillimin e kompetencave të parapara në kurrikulën për EFH. I gjithë mjedisi i Institucioneve Parashkollore ose i klasave parafillore, përfshirë ai i brendshëm dhe i jashtëm duhet të vihen në funksion të të nxënës, në funksion të përmbajtjes së të gjitha aspekteve të mbrojtjes së fëmijëve si dhe duhet që fëmijët të lihen të lirë t'i ndjekin interesat e tyre për realizimin e aktiviteteve në mjedis të jashtëm, në baza ditore. Kur përdoret teknologjia duhet pasur parasysh promovimin e përdorimit të sigurt dhe të dobishëm të saj. Aktivitetet në parandalim të rreziqeve janë të domosdoshme brenda funksionit edukativ të vetë institucionit.



KËSHILLA NËPËRMJET LOJËS

Përgjegjësia për mbrojtjen e fëmijëve në familje u takon prindërve, ndërsa në kontekst të institucioneve edukative u takon edukatorëve, prandaj në aktivitete me fëmijë duhet të kenë vend edhe këshillat e vlefshme e të përshtatshme për grumoshat e fëmijëve. Ekspozimi sa më i ulët i fëmijëve ndaj pajisjeve teknologjike, dhe madje mos-ekspozimi i tyre kur janë në moshë më të vogël duhet të jetë parim udhëheqës në planifikimin e aktiviteteve edukative, që duhet të realizohen përmes lojës. Megjithatë, edhe kurrikula për EFH-në ka të integruar zhvillimin e kompetencës teknologjike të fëmijët, e cila synon që fëmijët të jenë në gjendje t'i vënë në funksion avancimet teknologjike për ngritjen e njohurive e të shkathtësive të tyre si dhe të jenë në gjendje të identifikojnë rreziqet që mund t'u kanosen atyre në formë të përmbajtjes, mos-aktivitetit, ngacmimeve apo në formë të privatësisë, etj.

P.sh. Zgjidhni lojëra të përshtatshme për moshën, përmes së cilave fëmijëve u tregoni se përdorimi i tepërt i telefonëve e sidomos pa mbikëqyrjen e prindërve është me pasoja për shëndetin e tyre. Në aspektin edukativ, fëmijët në moshën e hershme janë në gjendje të mësojnë më lehtë shumë procese dhe shkathtësi

digjitale, siç është edhe kodimi. Prandaj, mund të mendohen ide që fëmijët të mësojnë aspekte themelore të kodimit në mënyrë që t'i çojnë drejt informatave të tjera, si për shembull kode që ua mundësojnë atyre të klasifikojnë pemët dhe perimet, varësisht nga zonat gjeografike ku rriten ato nga shijet e tyre, etj. Lojërat e përshtatshme për fëmijët janë kryesisht në faqe edukative, me specifikat e veçanta për moshat e caktuara.

Kur flisni me fëmijët parashkollorë përdorni gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për moshën e tyre: Përdorni një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për fëmijët parashkollorë, sepse vetëm ashtu ata mund të përfshihen në bashkëbisedim, mund të shfaqin mendime dhe të tregojnë nëse i përdorin pajisjet (telefon, laptop, etj).

Nëse ata tregojnë që e përdorin telefonin në masë të konsideruar, u bëni pyetje se përse e përdorin, çfarë lojërash pëlqejnë apo luajnë dhe vazhdoni me këshilla se si mund të jenë të vëmendshëm ndaj rreziqeve potenciale, dhe si ta reduktojnë kohën e tepërt të kaluar me pajisje teknologjike duke realizuar aktivitete e lojëra të tjera me bashkëmoshatarë dhe me familjarët e tyre!

Bashkëbisedimin mund ta realizoni duke luajtur me fëmijë, si në vijim:

Krijoni një rreth të madh me fëmijë, ndërkaq në qendër vendosni 3-4 fëmijë që dëshirojnë të nisin tregimin e tyre në përgjigje të pyetjes “A e përdorni internetin dhe pajisjet teknologjike? Nëse po, si i përdorni ato?”. Krahas diskutimit për internetin dhe teknologjinë u tregoni fëmijëve që secili fëmijë në rreth është një pikë e rrethit, ndërkaq fëmija në mes është qendra e rrethit. Nga qendra e rrethit, pra nga fëmijët në qendër dhe te secila pikë e rrethit (fëmijë në rreth), janë rrezet e rrethit (krahaso fëmijët me rrezet e diellit apo me çka duan ata të krahasohen, sepse edhe ndihen më mirë). Kështu fëmijët përmes komunikimit edhe mësojnë për sigurinë edhe mësojnë koncepte gjeometrike e hapësinore.

Në qendër të rrethit ndërrohen fëmijët me radhë, sipas dëshirës që të tregojnë përvojën e tyre në internet.

Si edukator/e, mbani evidencë për mendimet e fëmijëve, me theks për shqetësimet që mund t'i shpërfaqin dhe se si ndihen, sepse ato na tregojnë nëse ka çështje që duhet të adresohen me prindërit e tyre. Diskutoni me fëmijë për rreziqet e mundshme në internet, kërkoni nga ata t'i vendosin disa rregulla mbi sigurinë në internet dhe listoni ato!

P.sh.:

1. T'i përdorim telefonët apo laptopët vetëm me lejen e prindërve!
2. I vizitojmë faqet që na i sugjerojnë prindërit;
3. Bashkë me prindërit e caktojmë kohën sa gjatë mund t'i përdorim pajisjet teknologjike;
4. E largojmë pajisjen nga dhoma e gjumit;
5. Luajmë vetëm me familjarë dhe jo me njerëz të panjohur;

Ky aktivitet mund të realizohet dhe të përsëritet në faza periodike, ngaqë ndikon në ndërgjegjësim dhe në përcjelljen e situatës së fëmijëve sa i përket mbrojtjes në internet. Siç u pa, ky aktivitet është me qasje ndërkurrikulare lehtësisht i aplikueshëm (shih komunikimi, loja e rrethi si formë gjeometrike). Ngjashëm mund të shoqërohet diskutimi me vizatim e ngjyrosje apo edhe me improvizim të një teatri të vogël ku fëmijët lujnë rolet që mund t'i zgjedhin duke treguar përvojën e tyre në internet. Si edukator/e mund të krijoni edhe një skenar të vogël edukativ mbi përdorimin e sigurt të internetit (Gjeni shembuj, hulumtoni platforma edukative për fëmijë të moshës përkatëse!)

Për ilustrim, le të vendosen fëmijë në rreth, duke diskutuar nën udhëheqjen e edukatores, anash listës së rregullave të vendosura. Gjithashtu edhe shembulli i aktivitetit duke vizatuar e ngjyrosur dhe teatri.....

Promovoni ilustrimet edukative, aplikacionet edukative, videot edukative, animacionet edukative, dhe çdo gjë që ka karakter mësimi, edukimi, loje e argëtimi pa rreziqe dhe pa dëme (P.sh jo lojëra të dhunshme ku ka kanosje, vrasje, gjakderdhje!).

Ilustrim për lojëra edukative

Ilustrim për aplikacione edukative

6

Hapat që duhet të ndjekë edukatorja kur vëren sjellje të dhunshme te fëmija si shkak i përdorimit të medias

Kur diçka nuk shkon mirë me fëmijët ata kanë prirje ta shprehin menjëherë atë në sjellje, ndërsa edukatori/ja mund t'i identifikojë lehtë ndryshimet e fëmijës nëpërmjet sjelljeve, lojës, ndërveprimit me të tjerët, përmes vizatimeve e shumë formave të tjera.

Disa udhëzime të shkurtra për edukatorët kur vëzhgojnë se fëmija paraqet sjellje jo të përshtatshme, agresivitet e të cilat lidhen me përdorimin e medieve.

1. Vëzhgon sjelljet jo të zakonshme, ndërveprimin me fëmijët e tjerë dhe me edukatoren, lojën, etj.
2. Bisedon me fëmijën, gjithmonë duke u fokusuar te një bisedë mbështetëse dhe jo gjyquese ndaj fëmijës.
3. Mban shënime rreth bisedave, sjelljeve dhe për mënyrën se si ata iu tregojnë se si ndihen, etj. Ose përdor (p.sh. ditar vëzhgimi), fotografon në mënyrë që të ketë dëshmi për trajtimin e problemit me akterë të tjerë të kopshtit.
4. Kërkon mbështetje nga psikologu, edukatori special i kopshtit, etj.
5. Kërkon takim me prindër.
6. Etj.



7

Udhëzimet e edukatorit/ es për prindërit se si t'i mbrojnë fëmijët në internet

Edukatori/ja duhet t'u kujtojë familjeve se **prindërit duhet të jenë një model i mirë**, sepse **fëmijët janë imitues** të shkëlqyeshëm. Për këtë arsye, prindërit duhet të kufizojnë përdorimin e tyre të medias në prani të fëmijëve. Një lidhje më e madhe me fëmijët do të arrihet duke ndërvepruar, përqaftuar dhe duke luajtur me ta në vend të përdorimit të medias.

Ndani dhe informoni prindërit për platformat e vlefshme dhe të mira që i përdorni në kopsht, ua sugjeroni edhe atyre që t'i përdorin së bashku me fëmijët e tyre në shtëpi. P.sh. Aplikacioni për prindërim "Foleja", platforma e krijuar nga MASHTI me një arkiv të gjerë të aktiviteteve për fëmijë "Edukimi në distancë"¹⁰ janë platforma me informata të zhvilluara nga ekspertë të fushës dhe janë të besueshme për prindërit dhe fëmijët.

Familjet nuk duhet të përdorin **pajisje teknologjike si zëvendësues apo plotësues për zhvillimin e fëmijëve**, që t'i mbajnë të qetë fëmijët në publik, ngase kjo do të kufizojë zhvillimin e fëmijëve në vetë-rregullimin e emocioneve të tyre.

Fëmijët duhet, që pajisjet teknologjike t'i përdorin çdoherë **në prani të prindërve**.

Familjet duhet të **monitorojnë vazhdimisht përmbajtjen** e medias të fëmijët dhe aplikacionet që përdorin ose shkarkojnë, si dhe të aplikojnë kufizime që në shumë pajisje janë të realizueshme, në mënyrë që të ndalojnë qasjen dhe shfaqjen e përmbajtjeve të cilat shpërfaqin dhunë apo gjëra jo të përshtatshme për fëmijët.

Në raste kur edukatorët vërejnë që fëmijët po shfaqin emocione ose reague jo të zakonshme për ta dhe identifikojnë se shkakun qëndron në përdorimin e medias, atëherë edukatorët duhet t'u sugjerojnë

prindërve që fillimisht të takohen bashkë dhe të diskutojnë për çështjen dhe për vëzhgimet që kanë bërë, e sipas nevojës të sugjerojnë takime me profesionistë të tjerë për ekzaminimin e mëtutjeshëm.

¹⁰ <https://edukimihershem.rks-gov.net/>

Bazuar në hulumtime të ndryshme si nga Shoqata Amerikane, Australiane dhe ajo Italiane e Pediatriisë edukatorët gjatë punës mund t'u referohen rekomandimeve të hulumtimeve¹¹ në mënyrë që t'u rekomandojnë prindërve të mos përdorin pajisje mediatike:

- fëmijët nën 2 vjeç;
- gjatë vakteve;
- të paktën 1 orë para gjumit;
- në rast programesh me ritme të shpejta, aplikacione me shpërqendrim ose përmbajtje të dhunshme, etj.

T'u sugjerojnë prindërve të kufizojnë ekspozimin në medie të fëmijëve të këtyre grupmoshave:

- më pak se 1 orë në ditë te fëmijët e moshës 2-5 vjeç,
- më pak se 2 orë në ditë te fëmijët e moshës 5-8 vjeç.

KËSHILLA PËR PRINDËR

Nga persektiva juaj si edukatorë, jepni këshilla për prindër se si fëmijët t'i shmangen abuzimit me teknologjinë digjitale. Ju, sigurisht që e keni parasysh diversitetin kulturor, mentalitetin, nivelin e arsimimit të prindërve dhe rrethanat tjera sociale, prandaj këshillat institucionale janë të vlefshme dhe të dobishme brenda kornizave të bashkëveprimit me prindër për edukimin e mirë të fëmijëve.

P.sh.: Prindërit duhet të:

- Kalojnë kohë cilesore me fëmijë duke luajtur lojëra të ndryshme dhe kreative;
- Mbështesin fëmijët e tyre që të merren me vizatime, ngjyrosje, krijim materialesh e figurash që atyre u pëlqejnë;
- Udhëzojnë fëmijët për përdorimin e teknologjisë për qëllime edukimi, mësimi, informimi, kërkimi, loje e argëtimi brenda kohës së kufizuar për përdorim;
- Të ofrojnë vetë modelin e mirë të përdorimit të teknologjisë, ngaqë fëmijët modelojnë sjelljen e të rriturve;
- Diskutojnë me fëmijët për dobitë e internetit, të teknologjisë, por edhe për rreziqet që ekzistojnë;
- Edukojnë fëmijët që të mos përdorin teknologjinë me qëllim ngacmimi e dhune, por edhe të raportojnë dhunën e ngacmimin;
- Aktivizojnë filtrat e përmbajtjeve në pajisjet dhe në aplikacionet që përdorin fëmijët e tyre.

¹¹ Bozzola, E., Spina, G., Ruggiero, M. et al. Media devices in pre-school children: the recommendations of the Italian pediatric society. *Ital J Pediatr* 44, 69 (2018). <https://doi.org/10.1186/s13052-018-0508-7>

Siç thuhet në Udhëzuesin për prindër¹², të kontrollojnë për të parë nëse faqja e internetit ofron mundësi teknike të tilla, si:

- filtrimi dhe kontrolli prindëror;
- ruajtja e historisë së përdorimit të faqeve nga fëmijët e tyre;
- moderimi i përdorimit të faqeve nga ndonjë person, që shërben për bllokimin e materialeve ofenduese, duke reaguar ndaj sjelljeve të dyshimta dhe duke paralajmëruar përdoruesit;
- postimi i fotografive dhe videove;
- raportimi dhe bllokimi i shërbimeve dhe materialeve të papërshtatshme për fëmijë;
- verifikimi i moshës (shih më detajisht Udhëzuesin për prindër <https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-prinder/>).

PËRRALLËZA NË PËRPTHJE ME PROGRAMIN

Nëse duan të përcjellin mesazhe ndërgjegjësimi te fëmijët për sjelljen e mirë në internet, edukatorët mund të gjejnë dhe të përdorin përralla edukative me këtë tematikë. Më e mira është që fëmijët të nxiten ta krijojnë përrallën e vet. Mund të modifikohen përrallat e njohura, por edhe të provohet krijimi i teksteve të reja bashkë me fëmijët.

Në vijim jepen dy modele në shtojcën e udhëzuesit, të cilat ju sugjerojmë t'i përshtatni për grupmoshën e fëmijës, sigurisht në variante edhe më të mira! Te shtojca janë ofruar si shembull dy përralla për grupmoshën 5-6 vjeç, por nëse përdoren për mosha më të vogla duhet të thjeshtohen duke i përshtatur me fazën zhvillimore të fëmijës dhe me nivelin e përcimit të informatës.

¹² <https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-prinder/>)

REZULTATE

Ky udhëzues, i thjeshtë e praktik, sjell rezultatete të tri subjektet kryesore: edukatorë, prindër dhe fëmijë. Me përmbajtjen e vet mund dhe duhet që të orientojë dhe të nxisë punën e edukatorëve në mbrojtjen e fëmijës në internet dhe në përdorimin e pajisjeve teknologjike.

Përmes këtij udhëzuesi edukatorët fillimisht njihen me rregullat e përdorimit të teknologjise dhe të internetit, si:

- të përdorin burime të sigurta për informatat për aktivitete me fëmijë;
- të ruajnë privatësinë e secilit fëmijë duke ruajtur të dhënat dhe duke shmangur ekspozimin e tyre pa aprovim paraprak;
- të bartin te prindërit këshillat mbi edukimin dhe kultivimin e shprehive të mira të përdorimit të teknologjise dhe internetit para fëmijëve dhe me fëmijët;
- të monitorojnë sjelljet e fëmijëve dhe të reagojnë ndaj situatave në rast të dyshimit për abuzimin e fëmijëve online;
- të raportojnë sipas legjislacionit në fuqi (Ligji për mbrojtjen e fëmijës, Protokollin për parandalim dhe refererim të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar (IAP), Politika për mbrojtjen e fëmijës në IAP).

Gjithashtu prindërit sipas udhëzimeve nga edukatorët, arrijnë që:

- të kuptojnë rolin e tyre mbikëqyrës dhe mbrojtës përsa i përket përdorimit të internetit në familjen e tyre;
- të jenë model i mirë i sjelljes dhe praktikimit të teknologjisë para fëmijës së tyre;
- të njohin rreziqet në internet;
- të bashkëpunojnë me fëmijët dhe të përpiqen për parandalimin e pasojave negative në zhvillimin socio-emocional të fëmijës;
- të bashkëpunojnë me edukatorët në rast të identifikimit të shenjave të rrezikut dhe të raportimit për to;
- të bashkëveprojnë në aktivitete ndërgjegjësuese, etj.

Duke synuar zhvillimin e shkathtësive digjitale, krahas të gjitha shkathtësive e kompetencave të tjera, në këtë nivel fëmijët duhet t'i kuptojnë konceptet themelore, dobitë nga përdorimi, rreziqet potenciale dhe mënyrën e përdorimit të teknologjisë, siç janë:

- disa nga dobitë që i ka një shoqëri nga teknologjia dhe interneti dhe t'i thonë në mënyrën e vet të komunikimit (me fjalë, vizatime, lëvizje, mimikë);
- të njohin ilustrime që tregojnë shembuj të mirë të përdorimit dhe shembuj jo të mirë të përdorimit të internetit;
- të njohin shembuj praktikë dhe të jenë në gjendje të realizojnë aktivitete e lojëra të thjeshta, në të cilat teknologjia përdoret në mënyrën e duhur dhe ndihmuese për edukimin e tyre;
- t'i njohin disa rregulla të mira të përdorimit të internetit;
- të njohin disa nga rreziqet e mundshme nga përdorimi jo i duhur dhe i zgjatur i teknologjisë.

PËRMBYLLJE

Përdorimi i këtij udhëzuesi ndihmon personelin edukativ dhe mbështetës në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme në Kosovë. Përmbajtja e tij është orientim i mirë për punën e edukatorëve, të cilët aktivitetet e tyre duhet t'i përshtatin për grupmoshat e fëmijëve me të cilët punojnë.

Shembujt, aktivitetet, këshillat mund të përshtaten, por edhe të ideohen aktivitete të ngjashme, sepse besohet në profesionalizmin e edukatorëve për përgatitjen e aktiviteteve në përputhje me interesat dhe nevojat e fëmijëve, me fazën e zhvillimit të fëmijëve, dhe me zhvillimin e kompetencave të parapara me kurrikulën për EFH.

Shtojca 1

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Kombet e Bashkuara, 1990. Qasja nga: [https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-childdhe Microsoft Word - CRC Albanian.doc \(unicef.org\)](https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-childdhe_Microsoft Word - CRC Albanian.doc (unicef.org))

Ligji për mbrojtjen e fëmijës nr. 06/L-084, Qeveria e Kosovës, 2019. Qasja nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Udhëzim administrativ (qrk) nr. 04/2022 për Masat për mbrojtjen e fëmijës kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës, Qeveria e Kosovës. Qasja nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60529>

Politika për mbrojtjen e fëmijës

Module tematike për mbrojtjen e fëmijës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit, 2023. Qasja nga: <https://masht.rks-gov.net/module-tematike-permbrojtjen-e-femijes/>

Rregullore QRK-NR.21/2013 Për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, Qeveria e Kosovës, 2013. Qasja nga: <https://masht.rks-gov.net/rregullore-qrk-nr-21-2013-per-protokollin-per-parandalimin-dhe-referimin-e-dhunes-ne-institucionet-e-arsimit-para-universitar/>

Pakoja e udhëzuesëve tjerë të MASHTI për mbrojtjen e fëmijëve në internet. Qasja nga:

<https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-nxenes-femije-te-klasave-3-5-te-arsimit-fillor/>

<https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-femije-nxenes-2/>

<https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-mesimdhenes-2/>

<https://masht.rks-gov.net/udhetimi-neper-internet-udhezues-per-prinder/>

Shtojca 2

PËRRALLËZA I

Genci dhe shpella e internetit

Na ishte njëherë një djalë i vogël i quajtur Genc. Ishte shumë i zgjuar dhe i pëlqente të kuptonte e të dinte për çdo gjë që i dilte përpara. Çdo ditë e dëgjonte fjalën internet, në shtëpi, në rrugë, në televizion, te dajat, tezet, hallat, axhallarët e kudo. Si fëmijë e merrte shpeshherë telefonin e mamit ose babit, me ose pa leje dhe luante, po internetin nuk e dinte si fjalë, për ta shkruar e lexuar. Nuk e dinte ku ishte dhe nga vinte.

Një natë ra në gjumë me merakun për internetin. Mezi e zuri gjumi kah mesi i natës, por menjëherë sa iu rënduan qepallat e syve, atë e pushtoi një ëndërr. Ai po ecte një rrugë të shtruar plot tela, rrjeta, kablo, drita, laptopë të hapur, telefonë të mëdhenj e të vegjël dhe njerëz që flisnin, luanin, argëtoheshin, qeshnin, qanin, shkruanin... Dikush thoshte sa e bukur, dikush sa keq, dikush ishte frikësuar, dikush ishte hidhëruar, e tjerë plotë bënin bëëëzzzzzz si në zgjua bletësh. Genci ec e ec, ec e ec dhe në fund të rrugës u gjend para një shpelle të madhe e të mrekullueshme, pjesë-pjesë me ngjyra të llojllojshme e pjesë-pjesë e errët pa ndriçim. Tha dikush se ishte shpella e internetit. Genci u gëzua që e gjeti dhe ia mori vrapin drejt saj. Në hyrje seç mori në thua dhe gati ra në pjesën e errët dhe po të mos ishte mësuesja e tij që u gjend aty afër, ai kush e di se ku do të binte.

Bërtiti me sa zë që kishte dhe babi e mami i erdhën te shtrati për ta qetësuar. Kur Genci u tha se e kishte parë ëndërr shpellën e internetit dhe gjëra gjithfaresh. Ata i thanë: o shirti i vogël, duke u rritur do ta mësosh e kuptosh se internetin, me të mirat dhe rreziqet që ka, ndërkaq ne bashkë me mësuesen do të kujdesemi që ti të jesh i sigurt. Ëndrra të ka treguar që je i vogël dhe pa pëlqimin dhe përkujdesjen tonë nuk duhet të nisesh në rrugë të panjohura e me njerëz të panjohur. Edhe internetin e ke të panjohur dhe nga tani e duke u rritur do ta mësosh e kuptosh.

Udhëzime për edukatorët:

- Hap diskutim me fëmijët për atë se çka kuptuan nga kjo përrallëz!
- Çfarë ëndrre kishte parë Genci?
- Çka kishte parë e si ishte ndjerë?
- Çka e këshilluan prindërit Gencin?

PËRRALLËZA II

Zënka që bartin mësim

Një vajzë e vogël me emrin Yllka, po endej në lagje, sa poshtë sa lart, po kërkonte diçka. Fëmijët e lagjes i shkuan pas që të kuptonin se ç`kishte. Kur ç`të shihnin, ajo ishte takuar me një vajzë tjetër, Zanën, dhe po përlesheshin, po grindeshin. Rrupëllima dhe zhurma e tyre trazoi lagjen.

Fëmijët u munduan t`i ndanin e t`i qetësonin, por ato nuk ndaleshin dot. Për fat nuk u vonua dhe erdhi nëna e njërës nga to.

- Iu tha: Ç`keni moj që po zihen?
- Yllka i tha: - nuk e keni parë ju se si vajza juaj ka vendosur foton time në internet dhe është tallur me mua! Pas saj krejt po tallen e po më ngacmojnë...
- Nëna iu afrua Zanës, vajzës së saj dhe, sa me dhembshuri aq edhe me qortim i tha: Po pse vajza ime ke vepruar ashtu? Nuk duhet që foton e askujt ta postosh pa leje, as për të mirë e lëre më për qëllime talljeje apo ngacmimi. Është e ndaluar se është vepër e keqe. Si do të ndiheshe ti nëse dikush do ta bënte ty të njëjtën gjë?

Teksa i fliste nëna e vet, Zana, nisi të varte buzët dhe ia shkrepri vajit. Qante dhe nga sytë e bukur kaltërosh i rridhnin lotët. Në mes vajit e lotëve iu afrua Yllkës, e cila gjithashtu po i afrohej me dhembshuri.

Më fal shoqja ime, të lutem! Nuk e kam ditur që mërzitesh shumë. Kam gabuar dhe nuk do ta bëjmë këtë gabim, as për ty e as për askë tjetër! - i tha Zana.

Të kam falur, pa merak! E pashë sa u mërzite edhe ti. Gjërat e këqija nuk janë për neve. Ne duhet të luajmë bashkë dhe kurrë mos ta ngacmojmë njëra-tjetrën e as askë tjetër - i tha Yllka, dhe të dyja bashkë vrapuan në lëndinën e gjelbëruar për të luajtur.

Fëmijët e lagjes u befasuan, por morën mësim prej tyre. Ata thanë se nuk do t`i keqërdorin fotografitë e as të dhënat e askujt.

Pyetje për fëmijët:

1. A e keni kuptuar çfarë ka ndodhur me Yllkën?
2. Çfarë kishte bërë Zana?
3. A e pranoi gabimin Zana?
4. Kush i pajtoi vajzat?
5. Çfarë bënë vajzat në fund, a vepruan mirë?

Shtojca 3



Linqe relevante:

<https://edukimihershem.rks-gov.net/>

<https://fit-ks.org/>

<https://www.abcya.com/games/storymaker>

<https://www.storyjumper.com>

<https://tocaboca.com>

<https://www.sesamestreet.org/>

<https://www.abcmouse.com/abc/>

<https://pbskids.org/>

<http://www.tuxpaint.org/>

<https://www.youtube.com/watch?v=LiffkgGFUtk>

<https://theconversation.com/the-way-your-children-watch-youtube-is-not-that-surprising-but-it-is-a-concern-here-are-some-tips-87597>.

Rritu e mëso,

BIK+

Isigurt.org

YouTube Kids

Google Kids

Ky Udhëzues është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrojtja e Fëmijëve të cenueshëm në Kosovë", financuar nga Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe UNICEF në Kosovë, dhe implementuar në bashkëpunim me Qendra për Arsim e Kosovës - KEC.